NR:03-154
09.05.2025
Shkup

Në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 20 dhe neni 23 paragrafi (1) nënparagrafi 1 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr.184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr.42/20, 77/21, 154/23, 55/24 dhe 193/24), dhe në lidhje me nenin 14 dhe nenin 29 paragrafi (2) të Ligjit për Media („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr.184/13, 13/14, 63/24, 74/24 dhe 218/24), Udhëzimin për përmbushjen e detyrimeve për impresium dhe informacioneve të qasshme për përdoruesit, ark.nr.01-4443/1 datë 09.10.2018, pika 7 dhe 14 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndëmarrje të masës (Tekst i pastruar) ark.nr.01-4139/1 datë 07.11.2022, Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer administrative ark.nr.10-1555/1 datë 01.04.2025 dhe Konkluzionin nr.02-1997/7 datë 08.05.2025, Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, në seancën e 19-të mbajtur më 08.05.2025 miratoi si vijon:

Aktvendim
për ndërmarrjen e masës – vërejtje publike

1. PUBLIKISHT PARALAJMËROHET Shoqëria Tregtare Radiodifuzive (SHTR) TV DUE Nazmi SHPKNJP Gostivar, për shkeljen e kryer të nenit 14 të Ligjit për Media (LM), të mënyrës që transmetuesi në kuadër të shërbimit programor televiziv të transmetuar më 25 mars 2025, nuk ka publikuar impresium në: programet me përmbajtje fetare “Rregullat e shkurorzimit në islam”, lexim nga Kurani (tërësia audiovizive pa titull), “Drita islame” dhe „Besimi në Allahun xh.sh. dhe shpresa”; program dokumentar-argëtues „Kuzhina në ekran“ dhe në emisionin e ritransmetuar informativ-intevistë me Ardian Hoxha në “Albafon “Emision debativ - Meqë ra fjala”.

Shkelja nga paragrafi (1) i kësaj pike, është specifikuar në Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer administrative, ark.nr.10-1555/1 datë 01.04.2025, që është pjesë përbërëse e këtij Aktvendimi si Shtojcë nr.1.

2. URDHËROHET që SHTR TV DUE Nazmi SHPKNJP Gostivar, në afat prej 20 (njëzet) ditësh nga dita e pranimit të këtij Aktvendimi të harmonizojë punën e tij me dispozitat e LM.

3. Pas përfundimit të afatit të përcaktuar në pikën 2 të këtij Aktvendimi, të kryhet mbikëqyrje kontrolli, për të konstatuar nëse subjekti i mbikëqyrjes, i cekur në pikën 1 të këtij Aktvendimi, ka vepruar sipas aktvendimit.

4. Ky Aktvendim është përfundimtar dhe dita e miratimit do të llogaritet dita e çertifikimit në Arkivin e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (Agjencia).

A r s y e t i m

Agjencia në bazë të nenit 29 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (LSHMAAV) dhe neni 29 të Ligjit për Media (LM), është kompetente për të kryer mbikëqyrje administrative të punës së botuesve të medias nga aspekti i harmonizimit të punës së tyre me detyrimet e përcaktuara në nenent 6, 8, 14 dhe 15 të LM.

Në pajtim me nenin 23 paragrafi (1) nënparagrafi 1 të LSHMAAV, Këshilli i Agjencisë kundër botuesi të medias (transmetuesit) ndërmerr masë – vërejtje publike në rastet kur është kryer shkelje ose shkelje e dispozitave të LSHMAAV dhe akteve nënligjore të miratura në bazë të Ligjit të njëjtë, si dhe të kushteve dhe detyrimeve të përcaktuara në leje dhe akte të tjera të Agjencisë.

Në pajtim me nenin 29 paragrafi (2) të LM, masat që Agjencia si organ rregullator kompetent duhet t’i ndërmerr dhe që janë të përcaktuara në LSHMAAV, zbatohen në mënyrë adekuate dhe në rast të shkeljes së dispozitave të LM.

Sipas nenit 14 të LM, botuesi i medias është i detyruar në vendin të dukshëm për secilin bartës individual të përmbajtjes (për shembull kopje të medias së shtypur dhe emisioni televiziv) të

ofrojë publikimin e të dhënave në vijim: emri dhe adresa e selisë dhe redaksisë së botuesit të medias emri i personit përgjegjës të botuesit të medias, emri dhe mbiemri i redaktorit përgjegjës, përkatësisht redaktorëve në përputhje me organizimin e brendshëm të redaksisë dhe emri dhe adresa e shtypshkronjës dhe datën e botimit ose ribotimit si dhe numrin e kopjeve të botuara kur kemi të bëjmë me media të shtypit. Për transmetuesit detyrimi i lartpërmendur zbatohet në mënyrë të tillë që të dhënat publikohen në fillim ose në fund të programeve audio/audiovizive. Botuesi i medias është i detyruar në vendin përkatës për çdo përmbajtje të publikojë të dhënat në vijim: emri dhe mbiemri i autorit të fragmentit të publikuar, emri dhe mbiemri i personit përkatës të firmës që mban të drejtën autoriale të përmbajtjeve të publikuara, përveçse në median e shtypit dhe programeve në radio, datën e produksionit (vitin dhe muajin) kur kemi të bëjmë me vepër audio/audiovizuele dhe origjinën e veprës audio/audiovizuele dhe nëse vepra është krijuar nga produksion i pavarur dhe informacion për të, emri i personit juridik, përkatësisht emrin dhe mbiemrin e personit që e ruan veprën kulturore të përdorur ose veprën arkivore, përkatësisht reproduksionit përkatës dhe emrin e botuesit të medias nga ku është marrë fragmenti i programit ose pjesë nga fragmenti programor, nëse me marrëveshje të përbashkët nuk është rregulluar ndryshe.

Në pajtim me pikën 6 të Udhëzimit për përmbushjen e detyrimeve për impresium dhe informacioneve të qasshme për përdoruesit, ark.nr.01-4443/1 datë 09.10.2018, në programet e tjera të prodhimit vendor, impresiumi publikohet në këtë mënyrë: në shpicën hyrëse ose mbaruese të publikohen të dhënat në vijim: emri dhe mbiemri i redaktorit përgjegjës të shërbimit programor; emri dhe mbiemri i redaktorit përgjegjës të redaksisë nga ku buron programi (nëse ka); emri dhe mbiemri i redaktorit/autorit/drejtuesit (moderatorit) të emisionit; emri dhe mbiemri i bashkë-autorëve, përkatësisht të gjithë ekipit televiziv me pjesëmarrje në tërësinë e veprës audiovizuale; emrin e subjektit që ka prodhuar programin (të vetë transmetuesit, koproducentëve, producentit të pavarur të cilit i është porositur programi) dhe data e produksionit (muaji dhe viti). Nëse është e aplikueshme, duhet të publikohen dhe të dhënat për: emri i personit juridik, përkatësisht emri dhe mbiemri e personit që e ruan të mirën kulturore të përdorur ose veprën arkivore përkatësisht reproduksionin e veprës dhe emrin e subjekti tjetër nga ku është marrë një fragment i caktuar ose pjesë e fragmentit, vetëm nëse me marrëveshje të përbashkët nuk është rregulluar ndryshe.

Në kuadër të kompetencave Ligjore, Agjencia përmes Sektorit për çështje programore, me datë 1 prill 2025, ka kryer mbikëqyrje të jashtëzakonshme administrative (monitorim), (realizuar sipas detyrës zyrtare) të shërbimit programor televiziv të SHTR TV DUE Nazmi SHPKNJP Gostivar, transmetuar më 25 mars 2025, ku është konstatuar shkelja e nenit 14 të LM. Nga mbikëqyrja është konstatuar se në kundërshtim me Ligjin për Media dhe Udhëzimit për përmbushje të detyrimeve për impresium dhe informatave të qasshme për përdoruesit, pa impresium janë transmetuar programe me përmbajtje fetare me rastin e Festës së Ramazanit: “Rregullat e shkurorzimit në islam”, - lexim nga Kurani (tërësi audiovizive pa titull), “Drita islame” dhe „Besimi në Allahun xh.sh. dhe shpresa”; më pas programi dokumentar- argëtues „Kuzhina në ekran“ dhe emisioni i ritransmetuar-informativ, intervistë me Ardian Hoxha drejtor i “Albafon “Emision debativ - Meqë ra fjala”. Gjegjësisht, në vendin përkatës, për çdo përmbajtje të shërbimit programor, transmetuesi është i detyruar ligjërisht të transmeton të dhënat që do të identifikohen autorët që marrin pjesë në përgatitjen e përmbajtjes programore: - *emër dhe mbiemër të redaktorit përgjegjës të shërbimit programor; - emër dhe mbiemër të redaktorit përgjegjës të redaksisë nga ku buron programi; - emër dhe mbiemër të redaktorit / autorit / drejtuesit të emisionit; - emër dhe mbiemër të bashkautorëve, përkatësisht të gjithë ekipit TV me pjesëmarrje në tërësinë e veprës audiovizuele; - emër të subjektit që ka prodhuar programin; - data e produksionit.*

Shkelja nga pika 1 e këtij Aktvendimi, është specifikuar sipas datës, emrit të emisionit, periudhës së transmetimit (fillim dhe mbarim) dhe përshkrim në Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer administrative, ark.nr.10-1555/1 datë 01.04.2025, si pjesë përbërëse e këtij Aktvendimi si Shtojcë nr.1.

Në pajtim me nenin 23 paragrafi (3) të LSHMAAV, Këshilli i Agjencisë drejtuar SHTR TV DUE Naymi SHPKNJP Gostivar, me datë 02.04.2025, dërgoi Shkresë nr ynë.ark.10-1555/2 datë 02.04.2025, me të cilin i dorëzoi Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer administrative, ark.nr.10-1555/1 datë 01.04.2025, me qëllim që në afat prej 7 (shtatë) ditë pune nga dita e pranimit të shkresës, drejtuar Këshillit të Agjencisë të dorëzon deklarim me shkrim për shkeljen e kryer të dispozitave të LM. Shkresa është pranuar në mënyrë të rregullt nga transmetuesi më 07.03.2025. Në afatin e paraparë, përkatësisht më 29.04.2025, SHTR TV DUE Nazmi SHPKNJP Gostivar, drejtuar Agjencisë ka dorëzuar Deklarim me shkrim ark.nr.10-1555/3 datë 29.04.2025, Këshilli i

Agjencisë në saencën e mbajtur më 08.05.2025, pasi shqyrtoi lëndën Raport me shkrim dhe deklaratën e dorëzuar me shkrim nga SHTR TV DUE Nazmi SHPKNJP Gostivar, konkludoi që SHTR TV DUE Nazmi SHPKNJP Gostivar t'i shqiptoi masë - vërejtje publike. Këshilli i Agjencisë në seancën e 19-të mbajtur më 08.05.2025,pasi shqyrtoi lëndën Raport me shkrim,konkludoi që ndaj SHTR TV DUE Nazmi SHPKNJP Gostivar t'i shqiptoi masë – vërejtje publike.

Rrjedhimisht, në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 20 dhe neni 23 paragrafi (1) nënparagrafi 1 të LSHMAAV dhe në lidhje me nenin 14 dhe neni 29 paragrafi (2) të LM, Udhëzimin për përmbushje të detyrimit për impresium dhe informacione të qasshme për përdoruesit, pika 7 dhe 14 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrje të masës (Tekst i pastruar), Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer administrative ark.nr.10-1555/1 datë 01.04.2025 dhe Konkluzionin ark.nr.02-1997/7 datë 08.05.2025, për konstatim të mos respektimit të dispozitave të LM, përcaktuar në pikën 1 të këtij Aktvendimi, Këshilli i Agjencisë në seancën e 19-të mbajtur më 08.05.2025, miratoi Aktvendim me të cilin publikisht paralamëron SHTR TV DUE Nazmi SHPKNJP Gostivar, dhe urdhëron që në afat prej 20 (njëzet) ditësh nga dita e pranimit të Aktvendimit të harmonizojë punën e saj me dispozitat e LM,. Pas përfundimit të afatit përcaktuar në pikën 2 të këtij Aktvendimi, Agjencia do të kryen mbikëqyrje kontrolli, me qëllim të përcaktimit nëse subjekti i mbikëqyrjes i cekur në pikën 1 të këtij Aktvendimi, ka vepruar sipas Aktvendimit.

Në pajtim me nenin 24 të LSHMAAV, ky Aktvendim është përfundimtar dhe kundër këtij transmetuesi ka të drejtë padie për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për ngritjen e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit.

Bazuar nga sa më sipër, u miratua aktvendim si në dispozitiv.

Shtojcë (1):

1) Raport me shkrim për mbikëqyrje të kryer administrative ark.nr.10-1555/1 datë 01.04.2025.

Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuele
Kryetari i Këshillit,
Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.

Këshillë juridike: Kundër këtij aktvendimi transmetuesi ka të drejtë padie për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për ngritjen e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit.